



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
KOSOVA HANDBALL FEDERATION
RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

STATUTI I FHK-së

Federata e Hendbollit e Kosovës

10000 Pristina, Republic of Kosovo

Tel: +383 38 248 758

Fax: +383 38 248 759

Email: office@kosovahandball.info

Web: www.kosovahandball.info

Përmbajtja

STATUT TË FEDERATËS SË HENDBOLLIT TË KOSOVËS	2
1. EMRI, FORMA DHE ADRESA.....	2
2. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS.....	3
3. ANËTARËT E FEDERATËS.....	4
4. ORGANET E FEDERATËS	6
5. KUVENDI.....	6
6. BORDI	8
7. PRESIDENTI.....	10
8. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	11
9. KËSHILLI MBIKQYRËS	12
10. KËSHILLAT DHE KOMISIONET E BORDIT EKZEKUTIV	13
10.1. KËSHILLI PROFESIONAL.....	13
10.2. KOMISIONI PËR REGJISTRIM.....	13
10.3. KOMISIONI I ARBITRIMIT	13
10.4. KOMISIONI PËR AKTE NORMATIVE.....	14
10.5. KOMISIONI (KOMISARI) I GARAVE	14
10.6. KËSHILLI I GARAVE	14
10.7. KOMISIONI DISIPLINOR.....	14
10.8. KOMISIONI PËR INFORMIM DHE MARKETING	15
10.9. KOMISIONI SHËNDETËSOR DHE ANTIDOPING.....	15
10.10. KOMISIONI PËR MIRËNJOHJE.....	15
11. GARAT	16
12. REPREZENTACIONET	16
13. PASURIA, DHE MJETE MATERIALO- FINANCIARE.....	17
14. SHËRMBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL	17
15. RREGULLORET E BRENDSHME.....	17
16. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT	19

Në bazë të nenit 27 të Ligjit Nr.04/L-075 për sport të Kosovës dhe Ligjin nr 06/L-115, në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L- 043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare Udhëzimit administrative të akteve nënligjore dhe duke u bazuar në statutit të IHF dhe EHF Kuvendi i Federatës së Hendbollit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30 Shtator 2022 plotësoi dhe aprovoi këtë:

STATUT TË FEDERATËS SË HENDBOLLIT TË KOSOVËS

1. EMRI, FORMA DHE ADRESA

- 1.1. Federata e Hendbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Federata ose FHK), është asociacion i pavarur sportiv, i cili bashkon të gjithë hendbollistët, trajnerët, gjyqtarët, veprimtarët, drejtuesit e hendbollit si dhe dashamirët e këtij sporti në Kosovë nëpërmjet klubeve, shoqatave të hendbollit, pa marrë parasysh gjininë, ngjyrën, gjuhën, fenë, mendimin politik apo opinion e tij, prejardhjen sociale apo etnike, lidhjen me bashkësinë etnike pronën apo lindjen si dhe mbron qëllimin, realizimin e të drejtave, detyrave, obligimeve dhe programeve mbi bashkimin e të interesuarve të përcaktuar me këtë Statut.
- 1.2. Federata e Hendbollit e Kosovës Federata është subjekt juridik, e regjistruar në Ministrinë përkatëse për Administratë Publike, Departamenti për OJQ në Prishtinë, si një OJQ jofitimprurëse , sipas Ligjit nr.06/L-43 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare e cila vepron në pajtueshmëri me Ligjin për sportin në Kosovë, Ligjin mbi organizatat jofitimprurëse dhe Rregullave të EHF-it dhe IHF-it.
- 1.3. Emri i federatës është **FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS**, shkurtesa është **FHK**. Selia e federatës është në Prishtinë. Federata vepron në territorin e Kosovës.
- 1.4. Simboli i FHK-së është shenja e Federatës e cila përbëhet nga rrethi i rrumbullaket me ngjyrë të kaltër si dhe gjashtë yje nga më lartë me ngjyrë të arit në mes të rrethit shkurtesa FHK dhe anash rrethit në të majtë shkruan Federata e Hendbollit e Kosovës.
- 1.5. Flamuri i FHK-së ka formën sikur edhe simboli (materiali i mëndafshhtë).
- 1.6. Vula e FHK-së është e rrumbullakët, me shenjë të Federatës në mes dhe mbishkrimin:

FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
KOSOVA HANDBALL FEDERATION
РУКОМЕТНИ САЗЕЗ КОСОВА

- 1.7. Selia e Federatës së Hendbollit të Kosovës është në Prishtinë, Adresa:
FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
Shtëpia e sporteve (House of Sport) Kati II, nr.15
Rr. Agim Ramadani nr.253, 10000 Prishtinë, Kosovë
- 1.8. FHK-ja përgjigjet për obligimet e marra me të gjitha mjetet e saja: FHK-ja e ka xhirollogarinë e vetë pranë Bankës të cilën e përcakton Bordi i FHK-së.
- 1.9. Federata është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KOK).

- 1.9.1. Federata është anëtare e Federatës Evropiane të Hendbollit (në tekstin e mëtutjeshëm EHF) dhe Federatës Ndërkombëtare të Hendbollit ((në tekstin e mëtutjeshëm IHF).
- 1.9.2. Federata punon në bazë të akteve normative të veta, të cilat janë të harmonizuara me ato të MKRS-së, IHF-it, EHF-it dhe KOK-ut.
- 1.9.3. FHK do të zbatoj Ligjin përkatës 05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Tjera Negative në Ngjarjet Sportive, Ligjin përkatës për Sport, Ligjin përkatës për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe legjislacionin përkatës sekondar që dalin nga këto ligje;
- 1.9.4. Federata mund të anëtarësohet edhe në asociacione të tjera sportive vendore dhe ndërkombëtare.
- 1.10. Federatën e përfaqëson presidenti ose personi i autorizuar nga presidenti.
- 1.11. FHK-ja bashkëpunon dhe vepron me Ministrin e Sportit (Departamentin për sport), Shoqatat e trajnerëve dhe gjyqtarëve, Fakultetin e Shkencës së Kulturës Fizike, Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike si dhe asociacione të tjera jo vetëm sportive të cilat dëshirojnë këtë bashkëpunim.
- 1.12. Puna e Federatës është publike, dhe për punën e saj Federata opinionin e informon nëpërmjet:
Buletinave (Informatorëve), mjeteve të informimit, rrjeteve sociale si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave për media.
Anëtarët e vet i njofton nëpërmjet:
- Procesverbaleve të mbledhjeve të organeve dhe Këshillave dhe komisioneve,
 - Buletineve dhe publikimeve tjera, dhe
 - Mjeteve të informimit.

2. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS

- 2.1. Qëllimet e federatës janë: organizimi , masivizimi dhe zhvillimi kualitativ i hendbollit, udhëheqja e garave zyrtare dhe garave të tjera.
- Organizimi dhe përparimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve, vëzhguesëve etj.
 - Udhëheqja me reprezentacionet hendbollit të Kosovës,
 - Ngritja e cilësisë së hendbollit në shkallë kombëtare në këtë drejtim afirmimi ndërkombëtar i hendbollit kosovar
 - Themelimi i organizatave komunale të hendbollit dhe për mes tyre organizimi dhe zhvillimi i garave të rregullta i të gjitha kategorive
 - Përfaqësimi i klubeve të hendbollit të Kosoves në institucionet ndërkombëtare
 - U ndihmon organizatave të tjera në promovimin e hendbollit në të gjitha fushëveprimet e sportit të hendbollit, në përputhje me aktet normative.
 - Merr pjesë në manifestime dhe gara ndërkombëtare,
 - Mbështet zhvillimin e hendbollit në vise të pazhvilluara,
 - Merr pjesë në punën e KOK-ut dhe asociacioneve tjera sportive,
 - Vepron kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e KOK-ut dhe EHF-it dhe IHF-it.
 - Thellimi dhe kultivimi i marrëdhënieve të shëndosha që nënkupton tolerancën frymën olimpike, miqësinë, solidaritetin, transparencën, mos diskriminimin dhe ndershmërinë në lojë
 - Merr pjesë në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me hendboll.

3. ANËTARËT E FEDERATËS

- 3.1. Anëtarë të federatës janë: Klubet e hendbollit (publike dhe private), Shoqatat e trajnerëve, gjyqtarëve, e lojtarëve dhe të gjitha shoqatat tjera, të cilat do të pranohen nga federata. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për anëtarësim në federatë janë:
- Deklarata me shkrim e shoqatës, klubit për aplikimin dhe respektimin e Statutit dhe akteve tjera normative të FHK-së
 - Vërtetimi (certifikatën) për regjistrim i klubit apo shoqatës në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe komunën gjegjëse
 - Emrat e personave të autorizuar për përfaqësim
 - Numri i xhirollogarisë,
 - Aktet normative të subjektit (Statutin, Rregullorja për punën e Kuvendi aktin e themelimit)
 - Bordi i federatës i pranon anëtarët e rinj në anëtarësi të federatës.
- 3.2. Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve:
- që plotësisht t'i përmbahen Statutit, rregulloreve dhe vendimeve të FHK-së, IHF-së dhe EHF-së dhe që të sigurojë që këtë do ta bëjnë edhe anëtarët e saj;
 - të jenë korrekt ndaj FHK-së dhe të paguajnë të gjitha detyrimet financiare ndaj saj;
 - t'i komunikojë FHK-së çdo ndryshim në aktet e saja normative dhe në listën e personave zyrtarë dhe të autorizuarve për nënshkrim;
 - t'i respektoj rregullat e lojës së IHF, rregullat e lojës së hendbollit dhe kodin etik të IHF-së dhe EHF;
 - që aktet e saja normative të parashohin që të gjitha mosmarrëveshjet në nivel nacional do t'ia drejtojnë, si instancë e fundit, komisionit për arbitrazh të KOK-ut dhe me të cilën njohin kompetencën e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv në Kosovë.
 - të sigurojë zgjedhje të lira për organet e veta ekzekutive;
 - të merr pjesë në Kuvendin e FHK-së, të zgjedhë apo të kandidojë delegatët e vetë për Kuvend;
 - të merr pjesë në garat apo aktivitetet e organizuara nga FHK-ja, qoftë në nivel nacional qoftë në atë ndërkombëtar, komform kalendarit zyrtar;
 - janë përgjegjës të veprimeve të tyre dhe mund të sanksionohen në bazë të rregulloreve disiplinore në rast të mos përmbushjes së obligimeve apo thyerjes së rregullave që rrjedhin nga aktet normative të FHK-së dhe organeve të saj;
 - të mbaj evidencën e regjistrimit të të gjithë anëtarëve;
 - të bashkëpunojë në mënyrë të plotë me FHK-në, me organet dhe trupat e saja me qëllim të zhvillimit të lojës së hendbollit
- 3.3. Zhvillimi i aktivitetit në lëmin e hendbollit, organizimi i lojtarëve, punëtorëve sportiv dhe anëtarëve tjerë të cilët me vullnet të lirë janë të bashkuar realizohet në ekipet - klubet e hendbollit.
- 3.4. Klubet e hendbollit janë anëtarë të Drejtoratit të Sporteve në komuna në territorin ku e ushtrojnë veprimtarinë sportive dhe anëtarë të Shoqatës së klubeve të hendbollit të rangut të caktuar të garave.
- 3.5. Organizimi, të drejtat dhe detyrat e Lidhjeve, Shoqatave të hendbollit, më për së afërmi përcaktohen me Statut dhe Akte tjera normative të FHK-së, si dhe atyre ndërkombëtare të Hendbollit.

- 3.6. Klubet e hendbollit, të cilat janë të themeluara dhe të regjistruara në organet përkatëse komunale dhe Republikës së Kosovës, të cilat posedojnë me infrastrukturë të nevojshme, kuadër profesional, dhe se posedojnë vërtetimin me shkrim për regjistrim si klub në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
- 3.7. Si forma të organizimit dhe ndikimit në Federatë, janë Shoqatat e gjyqtarëve dhe trajnerëve të hendbollit, të cilat realizojnë të drejtat, detyrat dhe interesat e tyre të përbashkëta duhet të jenë në përputhje me dispozita të këtij Statuti, dispozitave tjera të Federatës, të IHF, EHF-it dhe Akteve të tyre normative.
- 3.7.1. Shoqata e gjyqtarëve dhe trajnerëve të hendbollit të Kosovës, si Shoqata profesionale të Federatës, formojnë organizatat përkatëse profesionale në nivele komunale të hendbollit, dhe sipas marrëveshjes mund t'i bartin pjesë të punëve, detyrave dhe autorizimeve. Shoqatat e gjyqtarëve dhe trajnerëve të hendbollit zbatojnë politikën në përputhshmëri me vendimet e aprovuara nga organet e Federatës.
- 3.7.2. Shoqata e trajnerëve (SHHTHK) dhe gjyqtarëve (SHGJHK) janë të obliguara që në çdo 6-të muaj, ti raportojnë me shkrim Bordit të FHK-së në lidhje me aktivitetin e tyre të punës dhe atij financiar.
- 3.7.3. Kurse Kuvendit të FHK-së janë të obliguara që ti raportojnë në Kuvendin e rregullte vjetor mbi aktivitetin e tyre të punës dhe ate financiar.
- 3.7.4. Statuti i Shoqatave të gjyqtarëve dhe të trajnerëve duhet të jenë në përputhshmëri me dispozitat e këtij Statuti.
- 3.7.5. Aktiviteti sportiv i gjyqtarëve të hendbollit, mbështet në baza të amatorizmit, ndërsa kompensimi për kryerjen e detyrës së gjyqtarit rregullohet me akte të veçanta normative dhe për këtë vendos Bordi i FHK-së.
- 3.8. Trajnerët dhe punëtorët tjerë profesional i realizojnë të drejtat dhe obligimet e tyre drejtë për së drejti në organizatat e hendbollit - klubet e tyre qoftë të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, qoftë në baza amatore.
- 3.8.1. Trajnerët për të punuar në klubet e hendbollit duhet të kenë kualifikimin përkatës të lëshuar nga organi kompetent i FHK-së.
Lëshuarja dhe marrja e lejes - licencës për ushtrimin e veprimtarisë së trajnerit më për së afërmi rregullohet me aktet normative të Shoqatës së trajnerëve dhe Rregullores mbi punën profesionale në organizatat e hendbollit.
- 3.8.2. Nëse Shoqatat e gjyqtarëve dhe trajnerëve, nuk ju përmbahet Statutit dhe Akteve normative të FHK-së, puna e tyre automatikisht do të pezullohen nga Bordi i FHK-së deri në krijimin e kushteve të reja për punë.
- 3.8.3. Çdo anëtar i federatës duhet ta paguaj anëtarësinë vjetore, të cilën e cakton Bordi i FHK-së.
- 3.8.4. Anëtari mund të dalë nga federata, atëherë kur nuk i kryen të gjitha obligimet financiare ndaj federatës dhe anëtarëve të saj apo nuk merr pjese ne gara.
- 3.8.5. Anëtari (klubi, shoqata) mund të përjashtohet nga Federata kur i shkel dispozitat e Statutit dhe akteve tjera normative të federatës dhe kur;
- nuk zbaton vendimet e obligueshme të federatës;
 - me veprimet e veta dëmton imazhin dhe reputacionin e federatës;
 - nëse konstatohet se organizata e anëtarësuar në FHK nuk ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe Ligjin për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Tjera Negative në Ngjarjet Sportive, apo konstatohet se gjatë dy viteve të fundit nuk e ka mbajtur Kuvendin dhe nuk ka marr pjesë në garat e rregullta

Vendimin për përjashtim e miraton Kuvendi nga anëtarësia e bie pas rekomandimit nga Bordi i FHK-së kurse në mbledhjen e radhës e miraton Kuvendi,. Eefektet e përjashtimit veprojnë nga dita e marrjes së Vendimit nga Kuvendi.

- 3.9. Përveç anëtarëve nga nenet e lartë cekura të këtij statuti, federata mund të ketë anëtarë mbështetës. Anëtarë mbështetës mund të jetë personi juridik, i cili komfor dispozitave të parapara me këtë statut me mjetet të dukshme financiare rregullisht e ndihmon dhe e mbështetë zhvillimin e veprimtarisë së FHK-së në realizimin e qëllimeve.
- 3.9.1. Anëtari mbështetës i FHK-së mund të ketë të drejtën e përfaqësimit në Kuvend, por pa të drejtë vote në organet e Kuvendit.
- 3.10. Anëtarësia në Federatë konsiderohet e pezulluar (e pushuar) për të gjitha klubet të cilat nuk marrin pjesë në garat e organizuara për edicionin aktual, apo të cilat nuk kanë marrë pjesë në gara përgjatë tërë stinorit paraprak, në rastet kur mbledhja e Kuvendit mbahet gjatë pauzës në mes stinorëve. Në një situatë të tillë delegatët e klubeve në Kuvendin e Federatës mund të jenë pjesëmarrës në cilësinë e vëzhguesit dhe pa të drejtë vote. Anëtarësia konsiderohet e ndërprerë për të gjitha klubet që nuk marrin pjesë në gara për dy vite.
- 3.11. Anëtarët e një organi të FHK-së duhet të shmangin çdo situatë që mund të çojë në një konflikt interesi ose konflikt të perceptuar të interesit. Çdo konflikt aktual, i perceptuar ose i mundshëm i interesit duhet të deklarohet dhe individit duhet të ndërmarrë veprime për të hequr veten nga situata ku mund të lindë një konflikt. Është përgjegjësi personale e secilit person të shmangë çdo rast të konfliktit të interesit.
- 3.12. Të gjithë anëtarët e organeve vendimmarrëse të FHK-së do t'i kryejnë detyrat në mënyrë të duhur dhe të pavarur, për interesat më të mira të hendbollit në Kosovë, pa marrë parasysh interesat e veçanta.
- 3.12.1. FHK-ja ka rregulloren përaktës të Kodit etik

4. ORGANET E FEDERATËS

- 4.1. Organet e federatës janë:
- Kuvendi
 - Bordi
 - Presidenti
 - Këshilli Mbikëqyrës

5. KUVENDI

- 5.1. Kuvendi është organi më i lartë qeverisës i Federatës, i cili përbëhet prej delegatëve të autorizuar të klubeve dhe Shoqatave të federatës.
- 5.1.1. Klubet përfaqësohen me nga një delegatë kurse Shoqatat në Kuvend përfaqësohen me nga dy delegatë.
- Përfaqësues në Kuvend mund të jetë personi:
- i cili është shtetas i Kosovës
 - i cili është i moshës madhore (mbi 18 vjet)
 - i cili është punëtor i afirmuar i sportit të hendbollit dhe i cili është i aftë për punë
 - i cili është anëtarë i organizatës së hendbollit të cilën e përfaqëson
 - i cili e pranon statutin e FHK-së
- 5.1.2. Në mbledhjet e Kuvendit mund të marrin pjesë delegatët të cilët duhet të kenë autorizim konform rregullave të FHK-së të dhënë nga klubet që ata i përfaqësojnë, si dhe mysafirët e ftuar pa të drejtën e votës.

- 5.2. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta, zgjedhorë dhe të jashtëzakonshme. Kuvendi i rregullt mbahet së paku një herë në vit, Kuvendin e rregullte e thërret Presidenti i FHK-së.
- 5.2.1. Ftesa për Kuvend të rregullt duhet të dërgohet më së largu 15 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali 7 ditë para Kuvendit.
- 5.2.2. Ftesa për Kuvend të rregullt zgjedhorë duhet të dërgohet më së largu 30 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali 21 ditë para Kuvendit. Ndërsa nominimi i kandidatëve për postin e presidentin, nën/presidentit dhe anëtarëve të Bordit bëhet 10 ditë para Kuvendit.
- 5.2.3. Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërrasin presidenti respektivisht Bordi i FHK-së, 2/3 të anëtarëve të Kuvendit si dhe Këshilli Mbikëqyrës kur konstaton shkelje ligjore në veprimtarin e FHK-së. Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta thërras presidenti, në afat prej 30 ditëve prej ditës së kërkesës, në të kundërtën, Kuvendin mund ta thërras edhe iniciuesi.
- 5.2.4. Kuvendi i jashtëzakonshëm vendosë vetëm për çështjet për të cilat është thirrur.
- 5.2.5. Mandati i delegatit të Kuvendit zgjatë katër vjet. Delegati i zgjedhur në Bord, pra që bëhet anëtar i Bordit, nuk mund të jetë edhe delegat i klubit në Kuvend, gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit si anëtar i Bordit të FHK-së.
- 5.2.6. Delegatit të Kuvendit mandati mund ti ndërpritet para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur për shkak të:
- revokimit apo shkarkimit të tij (klubi sportiv apo shoqata mund ta revokojnë apo shkarkojnë delegatin e tyre nga Kuvendi i FHK-së). Revokimi apo shkarkimi i kërkuar nga Klubi sportiv apo Shoqata vlen vetëm për pozitën e delegatit si përfaqësues në Kuvend, mirëpo jo edhe për pozitën tjetër të zgjedhura nga organet e FHK-së (Bord, Këshill profesional etj).
 - shkarkimit me kërkesë personale të delegatit
 - rrethanave të krijuara për shkak të cilave nuk do të mund të ushtroj detyrën e delegatit të Kuvendit
 - revokimit të delegatit të Kuvendit i nënshtrohet procedurës së paraparë për zgjedhjen e tij.
- 5.2.7. Mandati i delegatit të zgjedhur në këtë mënyrë zgjatë deri në përfundimin e mandatit të Kuvendit
- 5.3. Kuvendi mund të sjellë vendime në qoftë se janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit.
- 5.3.1. Kur kemi të bëjmë me çështje statutare, siç janë thirrja e Kuvendeve, mosbesimi i Bordit apo presidentit, ndërrimin e sistemit të garave duhet të jenë 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhje dhe të merret vendimi me votimin e 2/3 të delegatëve.
- 5.4. Kuvendi e zgjedh kryesinë e punës, procesmbajtësin, komisionin verifikues dhe në qoftë se ka nevojë edhe trupa tjera punuese (komisionin zgjedhorë, kur kemi Kuvend zgjedhorë).
- 5.4.1. Në mbledhje mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruajnë presidenti dhe dy (2) procesmbajtësit.
- 5.4.2. Kuvendi merr vendime me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, të cilët e kanë të drejtën e votës në rastet e pranimit dhe përjashtimit të anëtarëve, Shoqatave, Klubeve etj.
- 5.4.3. Në qoftë se vendoset për ndryshimet e Statutit, ose për pushimin e punës së Federatës, apo çështje tjera statutare për një gjë të tillë duhet të votojnë 2/3 të anëtarëve të pranishëm.
- 5.4.4. Votimi është publik në qoftë se Kuvendi nuk vendos ndryshe. Kuvendin e udhëheq Kryesia e punës, të cilën e përbëjnë: Presidenti i federatës dhe anëtarët e Bordit, kurse kur kemi Kuvend zgjedhorë pas votimit presidenti i zgjedhur apo rizgjedhur udhëheqë me mbledhjen e Kuvendit.
- 5.4.5. Vendimet e Kuvendit janë të obligueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e federatës. Procedura dhe mënyra e punës së Kuvendit, më përparësisht rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit.

- 5.4.6. Kuvendi mund të revokoj anëtarin e Bordit para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur nëse ai nuk e ushtron detyrën e tij konform të dispozitave të këtij statusit, përkatësisht vendimeve të Bordit dhe Kuvendit.
- 5.4.7. Kuvendi mund të revokoj edhe tërë Bordin kur konstatohet se për shkak të neglizhencës – mos punës dhe njohurive të pa mjaftuara në përgatitjen e punëve dhe detyrave nga programi i punës së Kuvendit dhe Bordit përkatësisht dokumentacionit për shqyrtim në organizatat e bashkuara të hendbollit, pengon punën dhe veprimtarin e Kuvendit gjegjësisht e pamundëson zbatimin e politikës zhvillimore në lëmin e hendbollit.
- 5.5. Shpenzimet e pjesëmarrjes në mbledhje të Kuvendit i bartë vet anëtari i Kuvendit.
- 5.6. Kuvendi në fushë veprimtarinë e vet i kryen këto punë:
 - Plotëson Ndryshon dhe miraton Statutin e FHK-së,
 - Miraton Rregulloren e punës së Kuvendit
 - Harton politikën e federatës,
 - Miraton planprogramin e punës
 - Miraton raportet e punës të organeve të veta,
 - Vendos për anëtarësimin e FHK-së në KOK, EHF dhe IHF dhe asociacione tjera,
 - Vendos për shpalljen e kandidaturës për Kampionatet botërore dhe evropiane të hendbollit si dhe garave tjera ndërkombëtare
 - Zgjedh dhe shkarkon presidentin, nën/presidentin dhe anëtarët tjerë të Bordit,
 - Zgjedh dhe shkarkon Këshillin Mbikëqyrës,
 - Vendosë në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike,
 - Vendos në lidhje me ndryshimin e sistemit të garave
 - Vendosë mbi faljen e dënimeve,
 - Miraton planin financiar të federatës
 - Vendos në bartjen e kompetencave tek organet tjera
 - Kryen edhe punë tjera në përputhje me Statutin dhe aktet tjera të federatës

6. BORDI

- 6.1. Bordi i FHK-së (në tekstin e mëtutjeshëm "Bordi") është organ ekzekutiv i Kuvendit dhe udhëheq me punën e Federatës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit.
 - 6.1.1. Mbledhjet i thërret Presidenti e në mungesë të tij nën/presidenti ose anëtari tjetër i Bordit të cilin e cakton presidenti.
 - 6.1.2. Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme, mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret nëse për një gjë të tillë deklarohet shumica e anëtarëve të Bordit të FHK-së
 - 6.1.3. Bordi i FHK-së tubohet sipas nevojës po më së paku një herë në tre muaj. Bordi i FHK-së për punën e vet i jep përgjegjësi Kuvendit të FHK-së.
- 6.2. Bordi i FHK-së numëron 11 anëtarë dhe përbëhet prej: Presidentit, nën/presidentit dhe nëntë anëtarëve tjerë, ku duhet të jenë 30% të gjinisë femërore.
 - 6.2.1. Kryetarët e Shoqatave të gjyqtarëve dhe trajnerëve automatikisht janë edhe anëtarë të Bordit dhe hyn në 11 anëtarët e Bordit.
 - 6.2.2. Anëtarët e Bordit të FHK-së zgjedhen nga Kuvendi me mandate katërvjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për dy (2) mandate tjera ashtu siç është e paraparë në EHF.
 - 6.2.3. Në Bordin e FHK-së duhet të jenë të përfaqësuara edhe minoritetet dhe gjinia femërore në përputhje me dispozitat e Ligjit për Sportin.

- 6.2.4. Të gjithë kandidatët për anëtarë të Bordit duhet të jenë të nominuar nga klubet në formularin e posaçëm të FHK-së dhe i cili duhet të dërgohet në zyrën e FHK-së 15-të ditë para Kuvendit.
- 6.2.5. Presidenti dhe nën/presidenti dhe Bordit zgjidhën me mandat katërvjeçar, kurse 7 anëtarë i zgjedh Kuvendi (me mandat katërvjeçar).
- 6.2.6. Kurse kryetarët e Shoqatave të gjyqtarëve dhe trajnerëve automatikisht janë edhe anëtarë të Bordit të FHK-së.
- 6.3. Në radhët e personave të propozuar për Bordin e FHK-së 30%, duhet të jenë persona të gjinisë femërore dhe më së paku 10% nga bashkësitë e pakicave etnike që jetojnë në Kosovë.
- 6.3.1 Zgjedhja e anëtarëve të Bordit bëhet me vota të fshehta.
- 6.3.2 Lista përfshinë emrat e kandidatëve dhe postet e tyre në Bord, kandidati i cili nominohet për një post, nuk mund të kandidohet edhe për një post tjetër.
- 6.3.3 Kandidati i cili është i dënuar në formë të prerë penale nuk mund të nominohet dhe zgjidhet për anëtar të Bordit.
- 6.3.4 Vendi i postit të anëtarit i cili zgjidhet nga radhët e minoriteteve, është e drejt e rezervuar. Presidenti i Bordit është edhe President i Kuvendit.
- 6.3.5 Nëse vjen deri te ndërprerja e parakohshme e mandatit të Bordit, Presidentit, nën/presidentit apo ndonjë anëtarit të Bordit me mbajtjen e ndonjë zgjedhje apo Kuvendi të jashtëzakonshëm zgjedhorë mandati i tyre nuk është me katërvjeçar por zgjatë deri në fund të ciklit Olimpik.
- 6.3.6 Në rastet kur ndonjë anëtarë i Bordi jep dorëheqje, nuk është aktiv konform Rregulloreve dhe Statutit të FHK-së apo ndërron jetë, në vend të tij Bordi automatikisht në mbledhjen e radhës emëron kandidatin i cili ka pasur më së shumti vota në Kuvendin e fundit zgjedhorë.
- 6.3.7 Anëtarë të Bordit të FHK-së mund të zgjidhen në të njëjtën funksion maksimum edhe për dy mandate, dhe në kohën e zgjedhjes apo rizgjedhjes, nuk duhet ta ketë arritur moshën prej 68 (gjashtëdhjetë e tetë) vite.
- 6.3.8 Zgjedhja për herë të parë në Bordin e FHK-së e anëtarëve të Bordit bëhet me anë të nominimit me shkrim nga klubi apo shoqata federata anëtare gjegjëse.
- 6.3.9 Bordi i FHK-së me rastin e rizgjedhjes së anëtarëve në Kuvendin e radhës mund të ri nominon kandidatët për pozita të presidentit, nën/presidentit dhe anëtarit të Bordit pavarësisht a është nominuar nga klubi apo shoqata gjegjëse e FHK-së.
- 6.4. Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes në Bordin e FHK-së, më përafërsisht rregullohen me Rregulloren mbi punën e Bordit dhe Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.
- 6.5. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të tërë Bordit, apo shumicës së anëtarëve të tij, Kuvendi do të zgjedhë një trup udhëheqës (Këshilli i Përkohshëm Udhëheqës) nga radha e delegatëve të Kuvendit, të përbërë nga 5 anëtarë, i cili do të kryejë funksionet e Bordit deri në mbledhjen e radhës së Kuvendit, në të cilën do të zgjedhën organet e reja. Afati për mbajtjen e mbledhjes së tillë të Kuvendit nuk mund të jetë më vonë se 45 ditë nga dita e zgjedhjes së trupit punues në fjalë. Në rast të tillë, përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Federatës dhe organizimin e Kuvendit janë Këshilli i Përkohshëm Udhëheqës, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës dhe punonjësit e shërbimit administrativ profesional të saj.
- 6.6. Bordi në fushë veprimtarinë e punës së vetë kryen këto punë:
- Propozon Statutin dhe aktet tjera Kuvendit,
 - Përgatit mbledhjet e Kuvendit dhe materialin përcjellës,
 - Ekzekuton vendimet e Kuvendit,
 - Miraton listën e zyrtarëve të ndeshjeve dhe Rregulloret e brendshme të Federatës,
 - Miraton listen e personave zyrtarë që përfaqësojnë FHK-në garat e EHF-it dhe IHF-it
 - Përpilon planin e punës dhe atë financiar të Federatës,
 - Vendos për blerjen ose shitjen e pasurisë së Federatës,
 - Emëron dhe shkarkon Sekretarin e përgjithshëm,

- Miraton plan programin e punës së Këshillit profesional,
- Emëron dhe shkarkon seleksionuesit e reprezentacioneve,
- Miraton raportet e Shoqatave, Këshillave dhe Komisioneve të Kryesisë,
- Miraton kalendarin dhe propozicionet e garave,
- Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës,
- Cakton lartësinë e anëtarësisë dhe kuotizimeve për anëtarët e Federatës,
- Cakton lartësinë e taksës për zyrtarë të ndeshjeve,
- Vendosë për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve në Federatë dhe për lartësinë e pagave të tyre,
- Emëron dhe shkarkon Këshillat dhe Komisionet e Bordit,
- Vendos edhe për çështjet tjera të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit.

6.7. Bordi mund të formojë komisione të përhershme dhe të përkohshme, vendos për kompetenca të tyre dhe emëron anëtarët e tyre. Komisionet dhe këshillat për punën e tyre i përgjigjen Bordit.

Komisionet-Këshillat e përhershme janë:

- Këshilli profesional,
- Komisioni - komisari i garave,
- Këshilli i garave (si organ i shkallës së dytë)
- Komisioni Disiplinor,
- Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve,
- Komisioni arbitrar
- Komisioni për Akte Normative,
- Komisioni për informim dhe marketing,
- Komisioni shëndetësor, dhe
- Komisioni për mirënjohje.

7. PRESIDENTI

- 7.1. Zgjedhja e presidentit për herë të parë në Bordin e FHK-së bëhet me anë te nominimit me shkrim nga klubi apo shoqatat gjegjëse të anëtarësuar në FHK.
- 7.2. Kandidati për president duhet ta ketë pëlqimin – përkrahjen e së paku 10 anëtarëve të Kuvendit. Nominimet duhet te dërgohen në zyrën e FHK-së 10 ditë para mbajtjes së Kuvendit zgjedhorë. Zyra e sekretariatit të FHK-së është e obliguar ti pranon kandidimet dhe te informon kandidatet dhe anëtarët e Kuvendit mbi validetin e kandidaturës.
- 7.3. Presidenti zgjidhet me vota te fshehta, në bazë të listës së kandidatëve. Kuvendi mund të vendos që presidenti të zgjidhet edhe me votim të hapët.
- 7.4. Në rast të zgjedhjes me votim, Presidenti i Federatës konsiderohet kandidati që ka fituar së paku një votë më shumë se gjysma e votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit. Në qoftë se asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryetar nuk e merr këtë numër të votave, atëherë në rrethin në rrethin e dytë të votimit delegatët e Kuvendit votojnë për dy

(2) kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë numrin më të madh të votave. Pas votimit në rrethin e dytë, për Kryetar zgjidhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave.

- 7.5. Bordi i FHK-së me rastin e rizgjedhjes së presidentit të mund të ri nominon, pavarësisht a është nominuar nga klubi apo shoqata gjegjëse e FHK-së.
- 7.6. Presidenti i Bordit të FHK-së mund të zgjidhen në të njëjtën funksion maksimum për tre mandate, dhe në kohën e zgjedhjes apo rizgjedhjes, nuk duhet ta ketë arritur moshën prej 68 (gjashtëdhjetë e tetë) vite.
- 7.7. Kandidati për president nuk mund të nominohet nëse ka ndonjë dënim për vepër penale me formë të prerë.
- 7.8. Nëse vjen deri te ndërprerja e parakohshme e mandatit të Presidentit për shkak të dorëheqjes, shkeljes së ligjit (dënimi i formës së prerë për vepër finale), vdekjes apo me mbajtjen e ndonjë Kuvendi të jashtëzakonshëm zgjedhorë mandati i presidentit nuk është me katërvjeçar por zgjatë deri në fund të ciklit Olimpik.
- 7.9. Presidenti në fushëveprimtarinë e vetë kryen këto punë:
- Kompetencat e Presidentit të Bordit janë:
- Presidenti i Bordit të FHK-së përfaqëson Federatën, thërret seancën e Bordit, udhëheqë me seancat e Bordit dhe të Kuvendit.
 - Përfaqëson Bordin dhe FHK-në në takime zyrtar brenda Kosovës dhe takimet ndërkombëtare,
 - Propozon anëtarët e delegacionit të FHK-së, dhe udhëheqësit e rrugës për takimet dhe ndeshjet ndërkombëtare
 - Nënshkruan vendimet e Bordit dhe të Kuvendit,
 - Kujdeset për zbatimin e plotë të programeve të punës dhe atyre financiare,
 - Nënshkruan Vendimet dhe konkluzat e Bordit dhe të Kuvendit,
 - Ka të drejtë vetoje në Vendimet e Bordit dhe organeve tjera deri në seancën e parë të Kuvendit,
 - Merr Vendime në kushte të jashtëzakonshme kur nuk mund të mbledhet Bordi dhe i njofton organet në momentin e parë të mundshëm Bordin, Kuvendin,
 - Ka të drejtë të pezulloj nga Bordi çdo anëtar të tij, nëse nuk është aktiv apo nuk vepron në frymën e akteve normative të FHK-së dhe synimeve të saj, deri në seancën e parë të Kuvendit,
 - Presidenti për punën e vetë i përgjigjet Kuvendit të FHK,
 - Presidenti mund të shkarkohet edhe para skadimit të afatit zgjedhor me humbjen e besimit ose me kërkesën e vet.
 - Për shkarkimin e presidentit, vendoset nëse me vota deklarohen mbi 2/3 e numrit të delegatëve të pranishëm në Kuvend.
 - Propozon Sekretarin e FHK-së dhe kryen edhe punë tjera sipas nevojës dhe kërkesave që kërkon momenti dhe Kuvendi apo Bordi.
 - Me vendim të bordit, nëse ky organ e sheh të arsyeshme, kryetari mund të ketë rol ekzekutiv.

8. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

- 8.1. Sekretarin e përgjithshëm e emëron Bordi me mandat katër vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes sipas konkursit të hapur. Kushtet të cilat duhet plotësuar janë;

- të ketë përgatitje të lartë (jurist, administrim, menaxhim)
- të ketë 5 vjetë përvojë pune në lëmin udhëheqëse të hendbollit
- të njehë gjuhën zyrtare të EHF-it
- të ketë aftësi pune në kompjuter

8.2. Sekretari i përgjithshëm në fushë veprimtarinë e vetë i kryen këto punë:

- Udhëheq me punën e zyrës së Federatës,
- Ekzekuton vendimet e Kuvendit, Bordit dhe të Komisioneve të Federatës,
- Realizon bashkëpunimin me EHF-in, IHF-in dhe me Federatat dhe organizatat tjera sportive jashtë Kosovës,
- Realizon bashkëpunimin me KOK-un, Departamentin e Sporteve dhe organizatat tjera sportive në Kosovë,
- Përgatitë mbledhjet e Kuvendit, Bordit, dhe të Këshillave e Komisioneve,
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve, Këshillave dhe komisioneve të Federatës në cilësinë e këshillëdhënësit.
- Mban kontakte me mjetet e informimit,
- Propozon Bordit, profilin e bashkëpunëtorëve profesional - administrativë,
- Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga aktet tjera normative të FHK-së.

8.3. Kur sekretari i përgjithshëm i FHK-së konstaton se aktet e përgjithshme apo ndonjëra prej tyre janë në kundërshtim me ligjet pozitive, apo në kundërshtim me statutin e FHK-së ai është i obliguar që ti tërheq vërejtjen Komisionit përkatës i cili e ka ndërmarr një veprim të tillë.

8.3.1. Nëse Komisioni apo grupi punues i cili e ka nxjerr një akt të tillë edhe përkundër vërejtjes së tërhequr mbetet pran veprimit të tij, sekretari për këtë obligohet ta njoftoj Bordin, Ministrin e Sportit e cila e mbikëqyrë ligjshmërinë e punës së FHK-së.

8.4. Sekretari i përgjithshëm themelon marrëdhënie të punës me Federatën në bazë të Ligjit mbi marrëdhëniet të punës.

8.4.1. Sekretari i përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit të tij, nëse nuk i kryen obligimet të cilat dalin nga aktet normative.

8.4.2. Sekretari mund të shkarkohet edhe para përfundimit edhe në këto raste tjera:

- nëse me punën e vet qëllimisht vepron kundër ligjeve të cilat aplikohen në Kosovë, statutit dhe akteve tjera të FHK-së, për shkak të cilave dëmtohet imazhi i FHK-së dhe shoqërisë në përgjithësi
- nëse pa arsye e refuzon zbatimin e vendimeve të Bordit
- me kërkesë të vetë
- me plotësimin e kushteve për pensionim dhe me vdekjen e tij

8.4.3. Sekretarin e përgjithshëm në rast të mungesës së tij e zëvendëson personi të cilin e cakton Bordi.

9. KËSHILLI MBIKQYRËS

9.1. Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej tre (3) anëtarëve.

9.1.1. Këshillin mbikëqyrës e zgjedhë Kuvendi me mandat katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandate.

9.1.2. Anëtari i Këshillit mbikëqyrës nuk mundë të jetë anëtarë i organeve dhe trupave të Federatës

9.2. Bordi dhe të gjitha trupat e tij janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës ti ja mundësojnë mbikëqyrjen në punën e tyre.

- 9.3. Këshilli mbikëqyrës përcjellë punën e organeve të Kuvendit në mes të dy Kuvendeve dhe mbikëqyrë afarizmin financiar të Federatës.
- 9.4. Këshilli mbikëqyrës i raporton për punën e vetë Kuvendit të FHK-ës.
- 9.5. Mënyra e punës së Këshillit mbikëqyrës më përparësisht përcaktohet me Rregulloren mbi punën e Këshillit mbikëqyrës.

10. KËSHILLAT DHE KOMISIONET E BORDIT EKZEKUTIV

10.1. KËSHILLI PROFESIONAL

- 10.1.2. Këshilli profesional është organ profesional i Federatës, i cili kujdeset për zhvillimin profesional të hendbollit.
- 10.1.3. Këshilli profesional numëron pesë (5) anëtarë, të cilët i emëron Bordi me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë. Për punën e vetë i përgjigjet Bordit.
- 10.1.4. Të drejtat dhe obligimet e Këshillit profesional janë:
- Të përcjellë zhvillimin e hendbollit brenda dhe jashtë,
 - Propozon sistemet e garave për të gjitha grup-moshat,
 - Të mbikëqyrë realizimin e plan programeve të aprovuara nga Bordi i FHK-së,
 - Kujdeset për zhvillimin profesional dhe popullarizimin e hendbollit,
 - Bashkëpunon me organizatat profesionale dhe shkencore me qëllim të përparimit të punës profesionale,
 - Propozon Bordit emërimin dhe shkarkimin e seleksionuesëve (trajnerëve) të Reprezentacioneve,
 - Kujdeset për përparimin profesional të trajnerëve dhe gjyqtarëve,
 - Propozon Bordit aprovimin e plan programeve për zhvillimin e hendbollit,
 - Kryen edhe punë tjera më të cilat e ngarkon Bordi i FHK-së.
- 10.1.5. Të gjitha vendimet në Këshillin profesional merren me shumicën e votave. Vendimet e Këshillit profesional janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.2. KOMISIONI PËR REGJISTRIM

- 10.2.1. Komisioni për regjistrim numëron tre anëtarë, të cilët i emëron Bordi i FHK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.2.2. Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve regjistron lojtarët gjatë afateve kalimtare dhe vendos për çështjet statusore të lojtarëve. Komisioni merr vendime me shkrim për regjistrimin ose mos regjistrimin e lojtarëve gjatë afateve kalimtare.
- 10.2.3. Komisioni i merr vendimet në bazë të Rregullores për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve dhe Ligjeve në fuqi.
- 10.2.4. Statusi i lojtarëve rregullohet më përparësisht me Rregulloren për regjistrimin e klubeve, lojtarëve dhe transferimin e tyre.
- 10.2.5. Të gjitha vendimet në Komisionin për regjistrim merren me shumicën e votave. Vendimet e Komisionit për regjistrim janë të plotfuqishme në qoftëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.3. KOMISIONI I ARBITRIMIT

- 10.3.1. Komisioni i arbitrit përbëhet nga tre anëtarë të cilët i emëron Bordi i FHK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.

- 10.3.2. Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes së Komisionit të arbitrimit, përcaktohen me rregullore të posaçme të cilën e miraton Bordi i FHK-së.
- 10.3.3. Të gjitha vendimet në Komisionin e arbitrimit të FHK-së merren me shumicën e votave. Vendimet e Komisionit të arbitrimit janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.4. KOMISIONI PËR AKTE NORMATIVE

- 10.4.1. Komisioni për akte normative përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FHK-së me mandat katër vjeçar, më të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.4.2. Komisioni për akte normative i FHK-së ka për detyrë ti përgatisë të gjitha aktet normative në kuadër të FHK-së (Rregulloret e ndryshme të Bordit të FHK-së, shoqatave apo komisioneve , të cilat duhet të jenë në përputhshmëri me aktet normative të IHF-it, EHF-it dhe AOK-ut, dhe të Ligjit për Sport dhe akteve nënligjore të DSK-së.
- 10.4.3. Të gjitha vendimet e Komisionit për akte normative të FHK-së merren me shumicën e votave.
- 10.4.4. Vendimet e Komisionit për Akte normative të FHK-së janë të plotfuqishme në qoftes në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.5. KOMISIONI (KOMISARI) I GARAVE

- 10.5.1. Komisioni (Komisari i garave) përbëhet prej një personi, kurse kur vendos Bordi te kemi Komision te garave ai përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët i emëron Bordi i FHK-së, me mandat një vjeçar ,me të drejtën e rizgjedhjes.
- 10.5.2. Bordi i FHK-së çdo vit me miratimin e Propozicioneve të garave vendos se a do të ketë Komision apo Komisar të garave.
- 10.5.3. Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes së Komisionit të (Komisarit) garave , përcaktohen me Propozicionet e garave të cilat i miraton Bordi i FHK-së.

10.6. KËSHILLI I GARAVE

- 10.6.1. Këshilli i garave është organ i shkallës së dytë i Bordit të FHK-së, i cili përbëhet prej tre (3) anëtarëve me mandat një vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes.
- 10.6.2. Këshilli i garave ka për detyrë që të mbrojë ligjshmërinë në shkallën e dytë, në ankesat të cilat kanë të bëjnë në lidhje me shkeljet e Propozicioneve të garave dhe Rregullores disiplinore në shkallë të parë (nga Komisioni – Komisari i garave). Për punën e vetë i përgjigjet Bordit të FHK-së.
- 10.6.3. Të gjitha vendimet në Këshillin e garave të FHK-së merren me shumicën e votave.
- 10.6.4. Vendimet e Këshillit të garave janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.7. KOMISIONI DISIPLINOR

- 10.7.1. Komisioni disiplinor përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FHK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.7.2. Komisioni disiplinorë vendosë në shkallë të parë në lidhje me shkeljet e Rregullores disiplinore, me të cilën më përafërsisht rregullohen të drejtat dhe obligimet e Komisionit, si dhe procedura e vendimmarrjes në lidhje me shkeljet disiplinore.
- 10.7.3. Të gjitha vendimet e Komisionit disiplinor të FHK-së merren me shumicën e votave.
- 10.7.4. Vendimet e Këshillit disiplinor janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.8. KOMISIONI PËR INFORMIM DHE MARKETING

- 10.8.1. Komisioni për informim dhe marketing përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FHK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.8.2. Komisioni për informim dhe marketing i FHK-së ka për detyrë dhe qëllim, që me punën e vetë, të ngritë vlerat e FHK-së, si dhe të informohet opinioni për punën e FHK-së, me anë të botimit të broshurave të ndryshme, revistës së FHK-së, rrjeteve sociale dhe njëkohësisht të kryej punë rreth marketingut të FHK-së me të cilin do të siguroheshin mjetet materiale për aktivitetet e FHK-së, qoftë në planin e brendshëm apo atë ndërkombëtarë.
- 10.8.3. Për ndihmë në realizimin e afarizmit të Federatës, mundë të punësohet zyrtari për marketing në përputhje me Ligjin mbi marrëdhënien e punës.
- 10.8.4. Të gjitha vendimet në Komisionin për informim dhe marketing merren me shumicën e votave. Vendimet e Komisionit janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.9. KOMISIONI SHËNDETËSOR DHE ANTIDOPING

- 10.9.1. Komisioni shëndetësorë përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FHK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.9.2. Komisioni shëndetësor ka për detyrë të kujdeset dhe të ruaj shëndetin e lojtarëve dhe të përfshirëve të tjerë dhe të . Këtu përfshihet edhe kujdesi që sporti të mbetet i pastër, pra që të ndalohet përdorimi i mjeteve të ndaluara stimuluese (dopingut). Komisioni e ka për detyrë të marr informatat e përditësuara për listën e substancave të ndaluara dhe me atë të njoftoj të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet e FHK-së. Po ashtu Komisioni ka për detyrë përcjelljen e të arriturave në mjekësinë sportive, për të mundësuar zhvillimin dhe avancimin e hendbollit.
- 10.9.3. Komisioni do të kujdeset që të përmbush obligimet që dalin nga Ligji Ligjin për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Tjera Negative në Ngjarjet Sportive
- 10.9.4. Në Komision duhet të ketë mjek të gjitha profileve mjekësore.

10.10. KOMISIONI PËR MIRËNJOHJE

- 10.10.1. Komisioni për mirënjohje prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FHK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.10.2. Komisioni për mirënjohje dhe shpërblime, ka për detyrë që ti propozon Bordit të FHK-së, sportistët apo institucionet për mirënjohje apo shpërblime, duke pasur parasysh angazhimin, punën, sukseset si dhe prezantimin e sportit Kosovar në vend dhe jashtë vendit.
- 10.10.3. Federata e Hendbollit e Kosovës parasheh këto mirënjohje dhe dekorata, për sportistët ekipet, Shoqatat, punëtorët sportive, gazetarët sportiv dhe individ tjerë si vijon:
 - Mirënjohje
 - Falënderime
 - Diploma për ekipe
 - Diploma për individ
 - Plaketa (e artë, agentë dhe e bronzit)
 - Medalje (e artë, agentë dhe e bronzit)
 - Shenja të FHK-së (e artë, e argjend dhe e bronzit)
 - Flamuj përkujtimor
 - Kupa
 - Dhurata dhe rekuizita sportive
 - Dhuratë speciale për masivitet, cilësi dhe fair - play
 - Dhuratë speciale, përcjellja e ndonjë manifestimi apo ngjarje me rëndësi sportive në Kosovë apo jashtë sajë
 - Dhuratë me të holla të gatshme

- 10.10.4. Të gjitha vendimet në Komisionin për mirënjohje dhe shpërblime merren me shumicën e votave. Vendimet e Këshillave dhe Komisioneve janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

11. GARAT

- 11.1.** Garat zyrtare të hendbollit në Kosovë mund të organizohen vetëm nga Federata (FHK), ose nga një organ i autorizuar nga Bordi i FHK-së, në këtë rast Komisioni i Garave apo Komisari i Garave në shkallë të parë dhe Këshilli i Garave në shkallë të dytë. Me saktësisht detyrat janë paraparë edhe tek neni 10.5 dhe 10.6 i këtij Statuti. Organizimi i garave të hendbollit në territorin e Kosovës është i paligjshëm dhe i palejuar.
- 11.2.** Garat zhvillohen në bazë të rregullave të EHF-it, IHF-it dhe rregulloreve të FHK-ës. Në udhëheqjen e garave organi përkatës i garave duhet ti respektoj të gjitha vendimet e IHF-it apo EHF-it dhe në bazë Ligjin për parandalimin e dhunës në sport dhe aktet tjera nënligjore apo udhëzimet të cilat dalin nga MKRS.
- 11.3.** Fillimin, shtyrjen, Propozicionet e garave kampionale dhe të Kupës i miraton Bordi i FHK-ës.

12. REPREZENTACIONET

- 12.1.** Federata është e obliguar që të kujdeset për punën e Reprezentacioneve dhe brenda mundësive financiare duhet tu mundësoj kushte sa më të mira për punë.
- 12.2.** Paraqitja për Reprezentacionin e Kosovës është obligim dhe nderë për çdo anëtarë të sajë. Federata mundë të miratoj rregullore të posaçme për punën e reprezentacioneve.
- 12.3.** Ngjyra e fanellave të reprezentacionit të Kosovës në hendboll, është kaltër dhe ngjyrë ari, ndërsa ngjyra rezervë e tyre është e bardhë me shenja të kaltër dhe verdhë, dhe ngjyra e arit me të kaltër.
- 12.4.** Caktimi i reprezentacionit të Kosovës në hendboll sipas kategorive, sigurimi i mjeteve për punë, kompetencat në udhëheqjen e punëve lidhur me reprezentacionin, stimulimi dhe shpërblimi i lojtarëve, sigurimi shëndetësor i tyre, stimulimi i kuadrit profesional, obligimet e klubeve ndaj reprezentacionit dhe përgjegjësia disiplinore më për së afërmi rregullohen me Rregulloren mbi reprezentacionet e hendbollit të Kosovës.
- 12.5.** Përzgjedhësit (seleksionuesit) e reprezentacioneve i zgjedhë Bordi i FHK-së në bazë të propozimeve të SHTHK-së dhe Këshillit profesional të FHK-së. Mandati i tyre është katërvjeçar, me mundësi të rizgjedhjes. Në bazë të konkursit publik.
- 12.6.** Trajnerët e reprezentacioneve i propozon seleksionuesi, kurse i emëron Bordi i FHK-së në bazë të verifikimit nga ana e SHTHK-së dhe Këshillit profesional të FHK-së.
- 12.7.** Për ndihmë në realizimin e plan programit të punës së reprezentacioneve, Federata me qëllim të krijimit të kushteve financiare, mundë të punësohet dhe emërohet Drejtori i reprezentacionit, ku më për afërmi do të rregullohen me Rregulloren mbi reprezentacionet.

13. PASURIA, DHE MJETE MATERIALO- FINANCIARE

- 13.1.** Federata financohet nga:
- Anëtarësia,
 - Donacionet e personave fizik dhe juridik,
 - Marketingu,
 - Të hyrave nga organizimi i garave dhe
 - Burimet tjera të lejuara në bazë të Ligjit.
- 13.2.** Me afarizmin financiar të Federatës përgjegjës është Presidenti i FHK-së, në bazë të planit financiar dhe vendimeve të Kuvendit dhe Bordit të FHK-së.
- 13.3.** Për ndihmë në realizimin e afarizmit të Federatës, mundë të punësohen zyrtar financiar në përputhje me Ligjin mbi marrëdhënien e punës.
- 13.4.** Federata mund të fitojë ne posedim pasuri të tundshme dhe të patundshme, Bordi vendos për fitimin e pasurisë së patundshme, për shitjen e saj, për bartjen e saj në personin tjetër juridik ose për dhënien me qira të pasurisë së patundshme.

14. SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL

- 14.1.** Federata mundë të themeloj marrëdhënie të punës me punëtorët të cilët do të punojnë në shërbimin profesional dhe administrativ të Federatës. Për punësimin e zyrtarëve dhe për lartësinë e pagave vendos Bordi i FHK-së, sipas Rregullores mbi Sistematizimin e vendeve të punës me propozim të Sekretarit të përgjithshëm.
- 14.2.** Federatat mund të punësoi zyrtarë për kryerjen e punëve në administratë, për zhvillimin e garave në rrafshin e brendshëm për punë teknike.
- 14.3.** Federatat mund të punësoi zyrtar për kryerjen e punëve në administratë, zyrtari i cili do të mbajë kontakte me EHF dhe IHF, si dhe federatat tjera ndërkombëtare, për zhvillimin e garave dhe aktiviteteve në rrafshin ndërkombëtarë.
- 14.4.** Federatat mund të punësoi zyrtar për kryerjen e punëve në administratë, zyrtar profesional i cili do të mbajë kontakte me shoqatën e trajnerëve dhe gjyqtarëve, përfaqësuesve, EHF-në dhe IHF-në, si dhe asociacionet tjera ndërkombëtare për zhvillimin e garave dhe aktiviteteve në rrafshin ndërkombëtar.
- 14.5.** Federata mund të punësoi zyrtar për kryerjen e punëve në administratë, zyrtarin profesional në bazë të Rregullores mbi sistematizimin e vendeve të punës të cilën e miraton Bordi i FHK-së.
- 14.6.** Me shërbimin administrativ të FHK-së udhëheq sekretari i përgjithshëm i FHK-së dhe i përgjigjet Bordit të FHK-së.

15. RREGULLORET E BRENDSHME

- 15.1.** Rregulloret e brendshme dhe propozicionet e garave nuk guxojnë të pësojnë ndryshime, gjatë edicionit garues i cili është në rrjedhën e sipër.
- 15.2.** Në procedurat administrative të cilat zhvillohen pranë organeve kompetente të Federatës mundë të përdoren mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

- 15.3.** Për çështjet administrative të cilat nuk janë rregulluara me këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e Kodit mbi procedurat administrative. (Deri në miratimin e Kodit të sipërpërmendur do të aplikohen dispozitat e Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative).
- 15.4.** Mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e individit dhe organizatave në FHK vendos Bordi i FHK-së, përveç në raste kur me këtë Statut dhe Akte tjera Normative të përgjithshme kjo e drejtë është bartur në kompetenca të Komisioneve ose trupave të tjerë të Bordit.
- 15.5.** Vendimet e Bordit të FHK-së të marra në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni janë përfundimtare dhe kundër tyre nuk lejohet ankesa.
- 15.6.** Kundër vendimit të Komisioneve dhe trupave të Bordit të FHK-së, mund të paraqitet ankesa Bordit të FHK-së në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.
- 15.6.1.** Bordi i FHK-së është e obliguar të vendos sipas ankesës në afat prej 30 ditëve, nga dita e paraqitjes së ankesës dhe vendimin e vet palëve të interesuara ua dorëzon në afat prej 8 ditëve.
- 15.6.2.** Në qoftë se në aktin përfundimtar të organit apo trupit tjetër të Bordit të FHK-së cenohen dispozitat e marrëveshjes mbi bashkimin e organizatave të hendbollit, dispozitat e Statutit dhe Akteve tjera Normative të Federatës individit i interesuar, organi ose organizata mund të iniciojë fillimin e procedurës për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë. Propozimi i tillë në formë të shkruar, i dorëzohet kryetarit të Kuvendit përmes Komisionit të Akteve Normative të Bordit të FHK-së në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së formës së prerë të aktit të kontestuar.
- 15.6.3.** Komisioni i Akteve i Bordit është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga dita e paraqitjes së propozimit duhet ta përgatisë arsyetimin me shkrim rreth afatit të paraqitjes dhe bazueshmërisë së propozimit e të cilin ia dorëzon kryetarit të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit është i obliguar në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së vendimit të Komisionit të Akteve të merr vendim nga propozimi.
- 15.6.4.** Në qoftë se kryetari i Kuvendit konteston se propozimi për paraqitjen e ankesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë është paraqitur pas afatit të paraparë merr vendim për hedhjen e propozimit si të paraqitur pas kalimit të afatit të paraparë.
Vendimi i nxjerrë në përputhje me paragrafin paraprak është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankesa.
Në qoftë se kryetari i Kuvendit konteston se propozimi është paraqitur në afatin e paraparë, të njëjtin ia dorëzon Bordit të FHK në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit të vet.
- 15.6.5.** Me rastin e marrjes së vendimit mbi propozimin e paraqitur të kërkesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë, Bordi i FHK-së mund të vendos që kërkesën ta aprovojë dhe aktin kontestues t'ia kthej organit kompetent në rishqyrtim dhe rivendosje, përkatësisht kërkesën ta aprovojë dhe aktin kontestues ta ndryshojë në aspektin e thënieve ankimore ose të njëjtin ta refuzojë si të pa bazë.
- 15.6.6.** Bordi i FHK-së është e obliguar që vendimin mbi paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë ta bien në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.


16. SHPËRBËRJA E FEDERATËS

- 16.1.** Federata mundë të shpërbehet me vendimin e 2/3 e anëtarëve të Kuvendit dhe nënshkruesit e marrëveshjes mbi bashkim në organizatat e hendbollit, kontestojnë se nuk ekzistojnë kushtet materiale dhe shoqërore për veprimtarinë e mëtejme dhe sipas forcës së Ligjit.

- 16.1.1. Në rast ë pushimit të veprimit të FHK-së, e gjithë pasuria e saj (aktive dhe pasive) i kalojnë trupit qeveritar apo organizatës e cila e merr përsipër te drejtat dhe detyrat e federatës dhe cila është në dispozicion të organizatave të hendbollit për përparimin e këtij sporti. Organizata e zgjedhur duhet të ketë qëllim të njejtë ose të ngjajshme sikurse Federata.

17. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

- 17.1.** Ky Statut hynë në fuqi ditën e aprovimit të plotësimeve nga Kuvendi i Federatës. Më hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i miratuar me 07.04.2022.
- 17.2.** Nëse ky Statut ne ndonjë pike has ne kundërthënies me Ligjin për sport, Ligjin për parandalimin e dhunës në sport dhe aktet tjera nënligjore apo udhëzimet te cilat dalin nga MKRS atëherë vlejné dispozitat e akteve normative që dalin nga Ligji për sport, Ligji për parandalimin e dhunës në Sport dhe udhëzimeve tjera administrative.
- 17.3.** Aktet e përgjithshme të FHK-së, Statutet e organizatave të hendbollit dhe aktet tjera nga lëmia e sportit te hendbollit duhet të harmonizohen në afat prej 90 ditë prej ditës se hyrjes ne fuqi te këtij statutit.
- 17.4.** Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen sipas procedurës se paraparë kur janë miratuar. Interpretimin e këtij Statuti e bënë Kuvendi i Federatës.

Eugen SARAÇINI

President i FHK-së

